

Seances Pleuro
06/04/2023



KUVENDI
NR 1224 DATE 06.04.23

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

KËRKESË

Kërkues: 35 Deputetë të Kuvendit të Shqipërisë (jo më pak se 1/4 e anëtarëve të Kuvendit).

Objekti: Kërkohet ngritja e Komisionit Hetimor të Kuvendit “Për verifikimin e ligjshmërisë së procedurave të ndjekura nga institucionet shtetërore për (i) identifikimin e projektit dhe të investitorit të Portit të Durrësit, (ii) për negociimin dhe ruajtjen e interesit publik, si dhe (iii) lidhjen e marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Eagle Hills Real Estate Development, Albanian Seaports Development Company, sh.a., dhe Nshmi Development L.L.C.”.”.

Baza Ligjore: Neni 77 i Kushtetutës së Shqipërisë, Neni 25 i Rregullores së Kuvendit, si dhe Ligji Nr. 8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”, të ndryshuar.

Drejtuar: Znj. Lindita NIKOLLA
Kryetare e Kuvendit.

Znj. Kryetare e Kuvendit,

Në mbështetje të Kushtetutës, të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, si dhe bazuar mbi Ligjin Nr. 8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”, të ndryshuar, ne deputetët e opozitës paraqesim kërkesën për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit, “Për verifikimin e ligjshmërisë së procedurave të ndjekura nga institucionet shtetërore për (i) identifikimin e projektit dhe të investitorit të Portit të Durrësit, (ii) për negociimin dhe

ruajtjen e interesit publik, si dhe (iii) lidhjen e marrëveshjes midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhe Eagle Hills Real Estate Development dhe Albanian Seaports Development Company Sh.A. dhe Nshmi Development L.L.C.”.

Në datën 08/11/2022, mazhoranca depozitoi për miratim me ligj në Kuvendin e Shqipërisë, me procedurë të përshpejtuar, Marrëveshjen midis “Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhe Eagle Hills Real Estate Development dhe Albanian Seaports Development Company Sh.A. dhe Nshmi Development L.L.C.”.

Nga diskutimi në seancat e Komisioneve Parlamentare të Ligjeve dhe ai i Veprimtarive Prodhuese, si dhe nga faktet e mbledhura nga media investigative, rezultojnë se procedurat e detyrueshme ligjore për të mbërritur në lidhjen e një marrëveshje të tillë, nuk janë respektuar nga disa institucione shtetërore, në shkelje flagrante të Kushtetutës së Shqipërisë, të Marrëveshtjes së Stabilizim-Asociimit, të vendimit nr. 29 datë 02.07.2021 të Gjykatës Kushtetuese (Vendimi mbi *Ligjin special Fusha*), të ligjit nr. 125/2013 “Për Konkensionet dhe Partnertitetin Publik Privat”, të ndryshuar, të Ligjit nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të legjislacionit mbi Ndhimën Shtetërore dhe atë mbi pronat e paluajtshme shtetërore.

Opozita ka denoncuar prej kohës projektin e Portit të Durrësit, projekt i cili sa më tepër dalin në pah dokumente në lidhje me investimin apo me investitorin, aq më shumë ngre dyshime serioze për shkelje të shumta ligjore nga ana e institucioneve shtetërore të Shqipërisë.

Qeveria socialiste e ka kaluar këtë marrëveshje me shpejtësi rekord në të gjitha nivelet e saj. Jo vetëm kaq, por trasparenca për këtë projekt, i cili është më i madhi i llojit të tij dhe që realizimi i tij do të sjellë zhvendosjen e portit më të madh tregtar të Shqipërisë në një vendndodhje tjetër, është thujse zero. Mazhoranca parlamentare kështu veproi edhe në Kuvendin e Shqipërisë, ku në datë 24.11.2022 nëpërmjet forcës së kartonave, Kuvendi miratoi me ligj të posaçëm marrëveshjen për kthimin e Portit të Durrësit nga porti më i madh në vend për mallra dhe udhëtarë, në një marinë jahtesh dhe varkash private, rrethuar me 12.600 njësi ndërtimore.

Asnjë debat publik për këtë projekt që prek zhvillimin e pronës me strategjike të Shqipërisë, si dhe asnjë konsultim me komunitetin e qytetarëve të Durrësit nuk ka ndodhur, siç e kërkon legjislacioni ynë dhe praktikat e mira ndërkombëtare. Tallja me qytetarët e Durrësit po bëhet akoma më e dukshme, kur mësohet se Bashkia Durrës paska filluar procesin e konsultimeve me banorët, në një kohë kur projekti dhe marrëveshja e detajuar është miratuar në Kuvend qysh më datë 24.11.2022. Pasi u injorua tërësisht opinionin e qytetarëve durrsakë pasi tashmë gjithçka është bërë fakt i kryer, Bashkia e Durrësit “është kujtuar” të kërkojë opinionin e qytetarëve të prekur drejtëpërdrejtë nga ky projekt.

Më konkretisht, nga faqja zyrtare e Bashkisë Durrës është publikuar njoftimi: “Njoftim për zhvillimin e Dëgjësës me Publikun të VNM-së për projektin “Porti i Integruar i Durrësit, Porto-Romano”, Durrës”. Njoftimi ka këtë përmbajtje: “Njoftim për zhvillimin e Dëgjësës me Publikun të VNM-së për projektin “Porti i Integruar i Durrësit, Porto-Romano”, Durrës. Datë 07.12.2022, ora

10:00, pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu", Ruga "Miqësia", Spitallë, Durrës". Njoftimi mban datën 24.11.2022 (ditën që projekti dhe marrëveshja u miratuan në Kuvend), ndërkohë, ftesa për diskutim me qytetarët, e publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës, është lënë për në datë 7 Dhjetor 2022.¹

Në të vërtetë, faktet e bëra publike janë tronditëse dhe nga ky projekt, Shqipëria rrezikon seriozisht të mbetet pa portin më të madh në vend. Porti i Durrësit i jep vendit një avantazh strategjik dhe ekonomik të pakrahasuar me vendet fqinje, si Kosova, Maqedonia e Veriut, apo Serbia, të cilat nuk kanë akses në det. Por ndërkohë, pikërisht në Portin e Durrësit, qeveria shqiptare ka vendosur që të ndërtohet një marinë yahtesh. Rrjedhimisht, me këtë projekt porti aktual dhe investimet e tij ndër vite do të prishen, edhe pse Shteti Shqiptar vazhdon e paguan kredi për investimet në Portin e Durrësit.

Sipas projektit parashikohet se në Durrës se do investohet rreth 2 miliard euro për 20 vite. Por nga ana tjetër, Shqipërisë mund t'i duhen jo më pak se 2 miliardë euro për të ngritur dhe bërë funksional portin e ri tregtar në Porto Romano. Pa llogaritur këtu koston e infrastrukturës shtesë si linja hekurudhore apo infrastrukturë rrugore. E gjitha kjo në këmbim të një marine me 280 vend-ankorime yahtesh dhe anijesh të vogla private. Ndërkaq, Shqipëria është duke humbur portin e saj më të madh të mallrave dhe udhëtarëve.

Investitorit privat do t'i kalohen mbi 80 deri në 150 hektarë tokë ndërtimore, në mënyrë që aty të ngrihen mbi 12.600 njësi ndërtimi (*Hotele, vila, apartamente, përfshirë një kazino*), në këmbim të 33% të fitimit të ardhshëm, një përqindje kjo ndjeshëm më e ulët se ajo që verifikohet në tregun real të pasurive të paluajtshme kur pronari i tokës jep tokën në shkëmbim të sipërfaqeve të ndërtimit. Pra, këtu qartazi kemi të bëjmë me një favorizim të ndjeshëm të investitorit strategjik, sepse atij i janë ofruar kushte shumë më përfituese se ato të tregut real. Kështu, fiton investitori por humbet interesi publik.

Një aspekt tjetër shumë i dyshimtë është edhe fizibiliteti ekonomik dhe financiar i projektit. Shteti shqiptar, sipas vetë planit të biznesit të paraqitur nga qeveria, do të fitojë rreth 280 milionë euro për të gjithë periudhën 20 vjeçare. Në të njëjtën kohë, vetëm përjashtimi nga taksat i investitorit strategjik (4% përjashtim nga taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe 3% nga taksa e banesave sociale), në total 7% të vlerës së projektit, është 150 milionë euro. Nëqoftëse këtu do të llogarisim edhe faktin se trualli prej 80 deri 150 hektarë, i jepet falas kompanisë së re të themeluar (sipas kontratës SPV me pjesëmarrje 67% të investitorit dhe 33% të shtetit shqiptar), atëherë kuptohet se kjo ndihmë shtetërore është e ndaluar, si dhe ajo tejkalon më shumë se 40% të vlerës së investimit. Ky fakt është shkatërrim i tregut dhe konkurrencës.

Ne vërejmë gjithashtu, në bazë të dokumenteve të paraqitur zyrtarisht nga qeveria shqiptare, se Shteti shqiptar nuk ka mundur të marrë asnjë garanci konkrete që në harkun kohor prej 20 vitesh, projekti të mos braktiset nga investitori strategjik. Pra në kontratën e negociuar, ndryshe nga standardi i kërkuar dhe i përdorur edhe në kontrata të tjera, përfshirë kontratat e ngjashme koncesionare apo PPP, të nënshkruara nga qeveria shqiptare dhe investitori (*kontrata në fuqi për Portin e Shëngjinit, për*

¹ <https://www.durres.gov.al/bashkia/njoftime-shpallje/1763-njoftim-per-zhvillimin-e-degjeses-me-publikun-te-vnm-se-per-projektin-porti-i-integruar-i-durresit-porto-romano-durres>

Portin e Vlorës apo atë të Sarandës), nuk kemi asnjë parashikim kontraktual për garancinë e kontratës. Ky është një tjerër favorizim që i bëhet investitorit strategjik dhe qartazi në dëm të interesit publik.

E verteta është se investitori do të investojë nga paratë e tij vetëm 3,4% të investimit total (ose 62 milionë euro), sepse 3,4% do të vijnë nga kredia bankare dhe 93.2% te investimit do të vijë nga shitja e apartamenteve, aktivitet ky që varet nga shumë faktorë të tregut. Ndaj, përpara nesh kemi pra një situatë ku investitori strategjik ka përfituar një kontratë pa garë dhe është lehtësuar ndjeshëm nga shumë taksa dhe detyrime të tjera. Interesi publik nga ana e negociatorëve të qeverisë jo vetëm nuk është ruajtur, por ekspozimi i qeverisë shqiptare dhe ekonomisë së vendit ndaj riskut është maksimizuar.

Së fundmi, mjaft e dyshimtë është edhe fushata promocionale në rrjete sociale, ku shihet qartë se kanë nisur reklamimet për shitje apartamentesh nga faja *Durresyachtsmarina*. Pra, fillon shitja në ajër e diçkaje që ende nuk ekziston, në një kohë kur:

- (i) ligji që miraton marrëveshjen nuk ka hyrë në fuqi ende sepse nuk është botuar në Fletoren Zyrtare, si dhe
- (ii) pa pritur as vendimarrjet e mundshme të Gjykatës Kushtetuese (e cila mund ta pezullojë zbatimin e ligjit deri sa çështja të shqyrtohet në themel).

Ku e gjen guximin investitori të propozojë për shitje diçka që nuk e posedon ende dhe për të cilën nuk gëzon (ende) asnjë të drejtë reale ?

Një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm është edhe çështja e transparencës së investorëve të projektit. Në këtë kontekst, sot:

- a. Qeveria Shqiptare nuk jep informacion mbi përfituesit fundorë (investitorët strategjikë) të këtij projekti;
- b. Kompanitë që kanë nënshkruar sëbashku me qeverinë shqiptare janë regjistruar në parajsa fiskale (offshore), gjë që e bën shumë të vështirë marrjen e informacionit për strukturën e ortakëve dhe mjetet financiare të shoqërisë.

Duke qënë se bëhet fjalë për një projekt madhor, realizimi i të cilit do të sjellë zhvendosjen e portit më të madh në Shqipëri, atëherë mendojmë se është transparenca absolute kusht i domosdoshëm për realizimin e këtij projekti.

Nisur nga këto informacione të bëra publike, për sa i përket identifikimit të projektit të Portit të Durrësit dhe të investitorit strategjik, procedurave të ndjekura që nga faza e negociimit dhe deri tek nënshkrimi i marrëveshjes, si dhe ruajtjes së interesit publik gjatë negociimit dhe rënies dakord për tekstin e kontratës, **konstatojmë se:**

Qeveria shqiptare, me veprimet aktive të saj dhe në mungesë totale të transparencës, gjatë hapave të ndërmarrë që nga identifikimi i projektit dhe investitorit strategjik deri te lidhja e kontratës, ka dëmtuar rëndë konkurrencën në treg dhe lirinë e sipërmarrjes, duke diskriminuar me qëllim të gjitha kompanitë shqiptare dhe të huaja nëpërmjet moslejimit me qëllim të garës.

Kështu:

- a. Qeveria shqiptare ka shkelur nenin 4, 11 dhe 17 të Kushtetutës;
- b. Qeveria shqiptare ka shkelur Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA), nenet 71 dhe 74 të saj ;
- c. Qeveria shqiptare ka miratuar sërish një ligj special, i cili bie në kundërshtim me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 29 datë 02.07.2021 (kundër Ligjit Nr. 37/2018, i njohur ndryshe si “Ligji special FUSHA”);
- d. Qeveria shqiptare ka shkelur ligjin për Pronat Publike;
- e. Qeveria shqiptare ka shkelur legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e konkurrencës;
- f. Qeveria shqiptare ka shkelur legjislacionin në fuqi për Ndihmën Shtetërore;
- g. Qeveria shqiptare nuk ka bërë transparencën e nevojshme lidhur me faktin se investitori është regjistruar në parajsa fiskale “off-shore”. Ajo nuk ka paraqitur asnjë dokument zyrtar që bën transparent cilët janë investitorët strategjikë të cilët do të sigurojnë financimin e këtij projekti dhe nesër do të kenë pronësinë mbi pronën më të vlefshme të shtetit shqiptar.

Qeveria shqiptare nuk ka hapur garën mbi një procedurë të tillë dhe kjo në vlerësimin tonë përbën shkelje të kuadrit ligjor vendas. Kushtetuta e Shqipërisë, Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, legjislacioni në fuqi për koncesionet dhe prokurimet publike, i kombinuar me atë të investimeve strategjike, kërkon që për projekte të tilla sikundër është edhe projekti i Portit të Durrësit, të ftohen kompani të interesuara vendasa dhe të huaja, pa kryer asnjë trajtim diskriminues ndaj kompanive vendase dhe atyre të evropiane. Negociimi i fshehtë i kontratës dhe përzgjedhja e një kompanie të caktuar, pa transparencë dhe pa garë, krijon dyshime të arsyeshme se projekti i Portit të Durrësit fsheh fakte dhe shkelje ligjore të cilat Komisioni Hetimor do të duhet t’i zbardhë.

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit parashikon në nenin 71 të saj se:

71/1(i) ...ndalohen të gjitha marrëveshjet ndërmjet sipërmarrjeve, vendimeve nga shoqatat e sipërmarrjeve dhe praktikave të bashkërenduara ndërmjet sipërmarrjeve të cilat kanë si objekt ose efekt parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës...

71/1(iii) ...ndalohet çdo ndihmë shtetërore e cila shtrembëron ose rrezikon të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar sipërmarrje të caktuara ose prodhime të caktuara.

Ndërkohë, në nenin 74 të MSA i titulluar “Kontratat Publike”, parashikohet qartë si një objektiv të MSA “*liberalizimin e kontratave publike në bazë të parimit të mosdiskriminimit dhe reciprocitetit*”, duke parashikuar gjithashtu se:

“kompanitë komunitare që nuk janë vendosur në Shqipëri gëzojnë të drejtën e fitimit të kontratës në Shqipëri në bazë të ligjit shqiptar [...] duke mos marrë një trajtim më pak të favorshëm se ai i dhënë shoqërive shqiptare”.

Përsa i përket Portit të Durrësit, përzgjedhja pa garë e projektit dhe investitorit, falja e tokës publike, si dhe lehtësitë e tjera si përjashtimi nga taksa e ndikimit në infrastrukturë (4%) apo përqindja e ndërtimeve sociale (3%), shtrembërojnë dukshëm konkurrencën, trajtojnë në mënyrë diskriminuese kompanitë e tjera vendase apo të huaja (Europiane), si dhe përbën ndihmë shtetërore të palejuar.

Kontrata bie plotësisht në kushtet e Ndihmës shtetërore të ndaluar, sepse ligji për Ndihmën Shtetërore në Republikën e Shqipërisë, përcakton se:

Neni 4

Ndalimi i ndihmës shtetërore

1. Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdo lloj forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”.

2. Format e ndihmës shtetërore përfshijnë kryesisht:

a) grantet dhe subvencionet;

*b) **përjashtimin, uljen dhe diferencimin e taksave;***

c) faljen e pagesave të prapambetura dhe gjobave;

ç) faljen e borxheve ose mbulimin e humbjeve;

d) garancitë mbi kreditë ose dhënien e kredive me norma interesi të ulëta;

dh) uljen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore;

*e) **uljen e çmimit të produkteve të ofruara, shitjen e pronës shtetërore nën çmimin e tregut ose blerjen e produkteve me çmim më të lartë se ai i tregut;***

ë) zmadhimin e kapitalit shtetëror të ndërmarrjet ose ndryshimin e vlerës së tij në rrethana, të cilat nuk janë të pranueshme për një investitor privat, që vepron në kushte ekonomike normale.

3. Çdo ndihmë e ndaluar është e rimbursueshme.

Siç edhe duket qartë, ky projekt ekonomik bie nën fushën e veprimit të Ligjit për Ndihmën Shtetërore. Kjo sepse, kompanisë i ofrohet ndihmë shtetërore në formën e përjashtim nga taksat dhe faljes së pronës publike, duke e vlerësuar atë dukshëm më ulët sesa vlera e tregut. Duke qënë se kjo ndihmë nuk mund të konsiderohet si *ndihmë horizontale* (sepse aplikohet vetëm për një kompani), nuk aplikohet në fushat e lejuara të ndihmës shtetërore si dhe shfaq karakteristikat e një ndihme shtetërore me intensitet shumë të lartë, rreth 40% e investimit, atëherë risku i dëmshpërblimit që BE mund të kërkojë nga paratë e taksapaguesve shqiptarë, është shumë i lartë!

Po kështu, ne kërkuesit gjykojmë se në rastin e projektit të Portit të Durrësit ekzistojnë shkelje të Ligjit 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar. Sikundër përmendet tek detyrimet e Shtetit shqiptar që rrjedhin nga MSA, **edhe ligji për mbrojtjen e konkurrencës ndalon “të gjitha marrëveshjet, të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht marrëveshjet që:**

- a) caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;
- b) kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;
- c) ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;
- c) zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta me palë të tjera tregtare, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
- d) kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që, për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave”.

Konkretisht, marrëveshja e Portit të Durrësit shfaq shkelje të legjislacionit për mbrojtjen e konkurrencës sepse vënia e pronës publike në dispozicion të privatit nën çmimin e tregut si dhe përjashtimet e taksave që lidhen me ndërtime, krijojnë zbatim të ndryshëm të kushteve për transaksione të njëjta me palë të tjera tregtare.

Nga ana tjetër, është shqetësues përjashtimi nga rregullat e prokurimit të projekteve madhore nga Qeveria shqiptare, e cila miraton ligje speciale për të shmangur zbatimin e normave të legjislacionit aktual në fuqi. Në rastin e ligjit special “Fusha”, (vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 29, datë 02.07.2021), Gjykata Kushtetuese pati rastin të sanksionojë procedurat e ndjekura me ligj special, duke u shprehur, ndër të tjera se:

“Nga ana tjetër ligjvënësi, nëpërmjet këtij ligji, i vendos në dispozicion pronën shtetërore atij subjekti, i cili në fazën paraprake siguron marrëveshje me pronarët e truallit ku përfshihet zhvillimi i projektit.

77. Në këtë drejtim Gjykata vëren se sipas parashikimit të nenit 11, pika 2, të Kushtetutës, prona private dhe publike mbrohen njëllë me ligj. Kjo do të thotë se, së pari, të dyja kategoritë e pronave gëzojnë mbrojtje kushtetuese dhe së dyti, se mbrojtja e pronës private edhe asaj publike, duhet të udhëhiqen nga parime të njëjta. Kurse ligjvënësi, duhet që në miratimin e ligjeve përkatëse për këto kategori pronash, të jetë i arsyeshëm dhe racional jo vetëm në lidhje me procedurat që duhet të ndiqen, por edhe me përmbajtjen e rregullave me qëllim ruajtjen dhe menaxhimin e pronës për interes publik.

[...]

81. Gjykata vlerëson se mungesa e fondeve financiare nuk përlligj interesin publik të miratimit të ligjit. Për më tepër kur kjo mungesë nuk ka qenë në vetvete shkak i miratimit të ligjit, sepse autoritetet publike, pasi procedura e ndjekur në zbatim të tij u shpall e pasuksesshme, ndryshuan qasje, duke vendosur t’ia nënshtrojnë realizimin e projektit pikërisht rregullave të

përgjithshme të prokurimit publik me fonde buxhetore. Autoritetet publike nuk arritën të bindin Gjykatën se kanë bërë përpjekje serioze në analizimin e mundësive të realizimit të projektit me fonde publike, pa përfshirjen e financimit të operatorëve ekonomikë privatë, për të maksimalizuar përfitimet në kuadrin e interesit publik.

82. Gjithsesi, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë rregullin e përgjithshëm se zhvillimi i zonave urbane mbart interes publik, do të vlerësojë në vijim nëse kjo ndërhyrje respekton kriterin e proporcionalitetit. Në lidhje me kriterin e përpjesëtimit të drejtë midis ndërhyrjes dhe gjendjes që e dikton atë, në mënyrë që kufizimi mos të cenojë thelbin e lirive dhe të të drejtave, jurisprudenca kushtetuese, veçanërisht për sa u takon mjeteve të përdorura, është shprehur se ligjvënësi duhet të zbatojë mjete të tilla ligjore, të cilat duhet të jenë efektive, pra të zgjedhura në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme për realizimin e synimeve që ndiqen. Përdorimi i këtyre mjeteve duhet të jetë i domosdoshëm, që do të thotë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera. Domosdoshmëria ka të bëjë, gjithashtu, edhe me përdorimin e mjeteve më pak të dëmshme për subjektet që u cenohen të drejtat dhe liritë. Kushti i përpjesëtimit të kufizimit me gjendjen që e ka diktuar, konkretizohet në kërkesën e domosdoshmërisë, dobishmërisë dhe të proporcionalitetit, në kuptimin strikt të kufizimeve të imponuara. Respektimi i këtyre kushteve kërkon një analizë të kujdesshme në çdo rast konkret, duke ballafaquar interesin publik që dikton kufizimin me ato të drejta që si rezultat i tij i nënshtrohen kufizimit, si dhe duke vlerësuar edhe mënyrën e kufizimit (shih vendimet 60, datë 16.09.2016; nr.33, datë 08.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese).

[...]

Në rastin në shqyrtim nuk rezulton që të jenë kryer vlerësime të plota dhe të argumentura për mënyrën e shkëmbimit të pronës shtetërore edhe në lidhje me vlerësimin ekonomik të saj.

[...]

85. Për arsyet e mësipërme, Gjykata vlerëson se argumentet e kërkuarit për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, parashikuar në nenin 11 të Kushtetutës në raport me nenin 17 të saj, janë të bazuara dhe duhen pranuar.”

Veçanërisht shqetësues në rastin e Portit të Durrësit, është edhe vendosja në dispozicion të investitorit e pronës shtetërore, i cili më pas mund t’a shesë atë për të gjeneruar fitime të mëdha, në dëm të interesit të përgjithshëm. Ligji Nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar, parashikon në nenin 12 të tij parimet e administrimit të pronës shtetërore. Sipas këtyre normave detyruese, administrimi i pronës së paluajtshme shtetërore siguron, ruajtjen dhe garantimin e interesit publik, ruajtjen e karakteristikave dhe të vlerave unike të pronës, ruajtjen dhe rritjen e vlerës ekonomike të pronës, si dhe ruajtjen e treguesve ekologjikë të njësisë së pronës së paluajtshme, sipas parimit të dobishmërisë më të madhe publike. Në rastin e projektit të Portit të Durrësit, shfaqen dukshëm dyshime serioze që prona shtetërore e zonës së portit dhe zonës përreth, nuk po administrohet sipas detyrimeve ligjore të sipërpërmendura. Përkundrazi, projekti i paraqitur i portit të Durrësit dëshmon për cenim të interesit publik, cenim të ruajtjes së vlerave ekonomike të portit, si cenim të vlerave unike të pronës.

Së fundmi, lidhur me projektin e Portit të Durrësit, në media është bërë e ditur se investitori nga Emiratet e Bashkuara Arabe është regjistruar në parajsat fiskale të tipit “off-shore”. Qeveria Shqiptare duhet të bëjë transparencën e nevojshme lidhur me këtë fakt dhe duhet të sqarojë se si është e mundur që mbrohet interesi publik, duke i besuar pronën shtetërore të portit të Durrësit një rrjeti kompanish të regjistruara në parajsat fiskale? Siç dihet, parajsat fiskale jo vetëm që shfrytëzohen për shmangie nga tatim-taksat, por ato përdoren veçanërisht për të fshehur emrin dhe identitetin e vërtetë të pronarëve, aksionerëve apo administratorëve realë që qëndrojnë pas atyre kompanive. Po t’i shtojmë këtyre shqetësimeve, edhe hapësirën që Marrëveshja për Portin e Durrësit lejon për shtimin apo transferimin e aksionerëve, apo për të gjetur financues tek të tretët, ndërkohë që llogaritë do të jenë në parajsat fiskale, kjo rrit ndjeshëm rriskun e arsyeshëm se pas kësaj Marrëveshjeje mund të ketë shkelje të legjislacionit penal, veçanërisht për pastrimin e produkteve të veprave penale.

Nëse këtyre argumentave, i shtojmë edhe mungesën e transparencës dhe të llogaridhënies nga ana e institucioneve shtetërore të vendit, qysh nga pikënisja e kësaj afere, kjo e bën çështjen e Portit të Durrësit një çështje e cila kërkon patjetër hetim të thelluar nga ana e një Komisioni Hetimor Parlamentar.

Në këtë kuptim, me qëllim shqyrtimin e të gjitha praktikave të deritanishme të ndjekura lidhur me aferën e Portit të Durrësit, si dhe me qëllim parandalimin e të gjitha praktikave të paligjshme, abuzive apo korruptive, si dhe duke pasur parasysh edhe rëndësinë që ka rritja e transparencës dhe e llogaridhënies për projekte të tilla investimesh madhore, gjykojmë të nevojshme ngritjen e një Komisioni Hetimor të Kuvendit për të verifikuar ligjshmërinë e procedurave të ndjekura nga institucionet shtetërore për (i) identifikimin e projektit dhe të investitorit të Portit të Durrësit, (ii) për negociimin dhe ruajtjen e interesit publik, si dhe (iii) për lidhjen e marrëveshjes midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhe Eagle Hills Real Estate Development dhe Albanian Seaports Development Company Sh.A. dhe Nshmi Development L.L.C.”.

Gjejmë me vend të theksojmë, se Gjykata Kushtetuese e ka cilësuar si “kompetencë kushtetuese” të drejtën e pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar për çështje të veçanta. Gjykata Kushtetuese është shprehur se kjo praktikë “...institucionalizon një lloj tjetër autoriteti kushtetues, që njihet si pushteti i pakicës parlamentare”, që realizohet “...në mënyrë të pavarur...” dhe që është “i pakufizuar nga vullneti i shumicës”. E drejta e kontrollit hetimor i është njohur pakicës parlamentare, e cila duke i pasur të kufizuara mjetet në dispozicion, mund ta shndërrojë atë në një instrument të fuqishëm për transparencë dhe llogaridhënie të ekzekutivit ndaj deputetëve, pjesë e pushtetit legjislativ.

Vetë ushtrimi normal i veprimtarisë së Kuvendit, kërkon ekzistencën e elementeve të domosdoshëm që kanë të bëjnë me krijimin e kushteve për respektimin e ligjeve nga të gjitha organet e tjera të pushtetit publik dhe shtetasit, si dhe pajisjen e tij me mjetet e përshtatshme për realizimin e kontrollit mbi mënyrën e zbatimit të ligjeve dhe mbrojtjen e interesit publik. Komisionet hetimore që ngrihen për këtë qëllim në kuptim të nenit 77 të Kushtetutës, janë një mjet që i shërben pikërisht ushtrimit të kontrollit parlamentar. Neni 77 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikon se:

“1. Kuvendi zgjedh nga gjiri i tij komisione të përhershme, si dhe mund të caktojë komisione të posaçme.

2. Kuvendi ka të drejtë dhe, me kërkesë të një së katërtës së të gjithë anëtarëve të tij, është i detyruar të caktojë komision hetimi për të shqyrtuar një çështje të veçantë. Përfundimet e tyre nuk janë detyruese për gjykatat, por mund t'i njoftohen prokurorisë, e cila i vlerëson sipas procedurës ligjore.

3. Komisionet e hetimit veprojnë sipas procedurës së parashikuar me ligj”.

Komisionet hetimore parlamentare janë instrumente të rëndësishëm të Parlamentit për mbledhjen e informacionit për çështje të veçanta, me qëllim arritjen e përfundimeve të caktuara.

Ndaj, nisur nga faktet dhe rrethanat e relatuar në këtë kërkesë, qëllimi i Komisionit Hetimor Parlamentar që kërkohet të krijohet mbi bazën e kësaj kërkesë, synon që të mbledhë informacione të hollësishme mbi zbatimin e ligjit në të gjitha praktikat e procedurave të ndjekura nga institucionet shtetërore për (i) identifikimin e projektit dhe të investitorit të Portit të Durrësit, (ii) për negociimin dhe ruajtjen e interesit publik, si dhe (ii) për lidhjen e marrëveshjes midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhe Eagle Hills Real Estate Development dhe Albanian Seaports Development Company Sh.A. dhe Nshmi Development L.L.C. Nga përfundimet që mund të arrihen nëpërmjet këtij Komisioni Hetimor, mundet që të vlerësohet nevoja për miratim, korrigjim, apo ndryshim të legjislacionit relevant në lidhje me investimet strategjike, investimet e huaja, administrimin dhe vënien në dispozicion të pronës shtetërore etj.

Objekti dhe qëllimi i ngritjes së këtij Komisioni Hetimor është në përputhje me Kushtetutën e vendit, për shkak se ky Komision Hetimor nuk sjell mbivendosje apo transferime të kompetencave të parashikuara nga Kushtetuta për organe të tjera, por synon kontrollin e ligjshmërisë së procedurave të ndjekura, me qëllim që të kontrollohet zbatimi i ligjit, të nxirren përgjegjësitë ligjore në rast se konstatohen shkelje, si dhe të merren masat e nevojshme për parandalimin e abuzimeve me pronën shtetërore.

Në këtë kontekst, është detyrë e Kuvendit të Shqipërisë, që pasi të kryejë një hetim dhe analizë të plotë të problematikës, të ndërmarrë veprimet e nevojshme parandalimin e abuzimeve me pronat shtetërore.

E drejta e Komisionit Hetimor për kryerjen e hetimeve do të realizohet vetëm brenda funksionit të kontrollit parlamentar, ndërsa deputetët pjesë e Komisionit Hetimor, si përfaqësues të popullit dhe të interesit publik, do të angazhohen për zbardhjen e plotë të kësaj çështjeje.

Ky hetim parlamentar është i dobishëm dhe konsiston pikërisht në nxjerrjen e përgjegjësisë institucionale, duke ndihmuar në evidentimin e problemeve aktuale, me qëllimin final mirëadministrimin e fondeve dhe parave publike, rritjes së transparencës dhe llogaridhënies nga pushteti ekzekutiv, si dhe mirëfunksionimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri.

Kërkesa për ngritjen nga Kuvendi të një komisioni hetimor parlamentar, i plotëson të tre kriteret kushtetues:

- (i) Çështja ka të bëjë me funksionin ligjvënës dhe funksione të tjera për të cilat ai është i autorizuar të marrë masa ligjore;
- (ii) Objekti i hetimit të Komisionit Hetimor Parlamentar fokusohet në një çështje konkrete; dhe
- (iii) Ekzistojnë të dhëna publike dhe indicie të mjaftueshme që dëshmojnë për ekzistencën e mundshme të shpërdorimit të detyrës apo praktikave të tjera abuzive, lidhur me çështjen e Portit të Durrësit.

Kjo kërkesë për ngritjen e një Komisioni Hetimor, bazohet në nenin 77, pika 2 e Kushtetutës si dhe neni 25 i Rregullores së Kuvendit, i cili parashikon se *“Kuvendi ka të drejtë dhe, me kërkesën e një të katërtës së të gjithë anëtarëve të tij, është i detyruar të caktojë një komision hetimi, për të shqyrtuar një çështje të veçantë. 2. Komisionet hetimore të Kuvendit veprojnë sipas procedurës së parashikuar me ligj”*.

Përfundimisht, duke pasur parasysh sa më sipër, ne, një grup deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë, bazuar mbi dispozitat në fuqi të Kushtetutës dhe ato të Rregullores së Kuvendit,

KËRKOJMË:

1. Ngritjen e një Komisioni Hetimor të Kuvendit, *“Për verifikimin e ligjshmërisë së procedurave të ndjekura nga institucionet shtetërore për (i) identifikimin e projektit dhe të investitorit të Portit të Durrësit, (ii) për negociimin dhe ruajtjen e interesit publik, si dhe (iii) për lidhjen e marrëveshjes midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhe Eagle Hills Real Estate Development dhe Albanian Seaports Development Company Sh.A. dhe Nshmi Development L.L.C.”*.

2. Komisioni do të ketë për objekt të veprimtarisë së tij: (i) shqyrtimin e të gjitha praktikave dhe të procedurave të deritanishme të ndjekura nga institucionet shtetërore për identifikimin e projektit dhe të investitorit të Portit të Durrësit, (ii) shqyrtimin e ligjshmërisë e të gjitha praktikave dhe të procedurave të deritanishme të ndjekura për negociimin dhe lidhjen e marrëveshjes midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhe Eagle Hills Real Estate Development dhe Albanian Seaports Development Company Sh.A. dhe Nshmi Development L.L.C., si dhe (iii) vlerësimin e nevojës për miratimin, plotësimin apo korrigjimin e kuadrit ligjor relevant për të parandaluar abuzimet dhe shkeljet e mundshme me përdorimin e pronave shtetërore lidhur me investimet madhore në vend.

3. Komisioni do të përbëhet nga 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarë, nga të cilët kryetari dhe gjashtë anëtarë i përkasin Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kurse tetë anëtarë Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste.

4. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 4-mujor nga data e miratimit të këtij vendimi.

5. Mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve për shqyrtimin e kësaj kërkesë dhe caktimin e datës së miratimit në Kuvend në seancën plenare më të afërt.

Duke ju falenderuar,

GRUPI I DEPUTETËVE

1. BELIND KELLICI Belind Kellici
2. Ilir Vahshi Ilir Vahshi
3. Titus Idrizi Titus Idrizi
4. Ina Zhupa Ina Zhupa
5. Kastriot Idrizi Idrizi 2009/2022.
6. Zeynep Zeynep Zeynep
7. Enise Koto Enise Koto
8. Lindita Metaliq Metaliq
9. Adem Baci Adem Baci
10. Karem Mahmuti Karem Mahmuti
11. Elda Hoti Elda Hoti
12. Sali Nushi Sali Nushi
13. Dard Bylykbashi Dard Bylykbashi
14. Lutfi Bashi Lutfi Bashi
15. Selman Selman Selman
16. Fati Fati Fati
17. Agim Agim Agim
18. Bujar Celiku Bujar Celiku

18. Fefat Vani
19. GRISA Xixho
20. AUROR SHENTAY
21. Touro Alizot
22. Enoir Sali
23. Ed. PARONA
24. Xichel
25. Petat
26. Saimir
27. Greda
28. PPM
29. Merita Bochin
30. Guide Tolu
31. Flobo
32. Moni he
33. Fardat
34. Hammy
35. Zheri
36. Kape
37. Kape